

C.nr.118/2014

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit B [REDACTED] R [REDACTED] nga Ferizaji [REDACTED], të cilin e përfaqëson av.Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaji,kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaji, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, të cilën e përfaqëson në cilësin e përfaqësuesit të përkohshëm av.Jakup Ramadani nga Ferizaj,pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë me datë 31.05.2017, mori këtë:

AKT GJYKIM

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadi e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, dhe vërtetohet se paditësi [REDACTED], nga Ferizaj është pronarë i ngastrave kadastrale [REDACTED] të cilat ngastra gjinden në Zonën Kadastrale Kosinë.

A r s y e t i m

Paditësi Bajrush Reshani , nga Ferizaji, ka parashtruar padi në këtë Gjykatë kundër të paditurit [REDACTED] ish nga Ferizaj, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, me bazë juridike vërtetimi i pronësis. Paditësi gjatë shqyrtimit kryesorë ka theksuar: është e vërtet se unë në vitin 1984 paluajtshmërinë kontestuese e kam blerë nga i padituri [REDACTED] për qmimin e shitblerjes prej 200 milion dinarë, të cilën shumë ia kam paguar në tërësi, të paditurit [REDACTED] kurse i padituri [REDACTED] më ka lejuar që ta shfrytëzoj tokën kontestuese. Paluajtshmëria kontestuese më sa më kujtohet i ka rreth 64 ari dhe 49 metra .Unë tokën në fjalë, e shfrytëzoj nga viti 1984 e deri tani 2017, pa u penguar nga askush, sepse e kam blerë. Paluajtshmëria kontestuese gjindet në fshatin Kosin, është me kulturë livadhe dhe është afër shtëpisë time, ashtu që rruga e ndanë atë tokë nga shtëpia ime Unë e kam njohur [REDACTED] pasi që e ka shitur këtë tokë, ai është larguar nga [REDACTED] dhe nuk e dij venqendrimin e tij. E dij që [REDACTED] kur e shiti tokën i mori parat e shitblerjes nga unë dhe i futi me një këse, dhe tha; “e shtina arën në këse dhe u gëzua”.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit av.Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaji ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se paditësi [REDACTED] është pronarë i ngastrave kadastrale [REDACTED] Zona Kadastrale Kosinë dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av.Jakup Ramadani nga Ferizaji ka theksuar: në lidhje me këtë qështje civilo juridike ku si objekt i shqyrtimi është vërtetimi i pronësisë, unë si përfaqësues i përkohshëm i të paditurit në kompetencë gjykatës që të vendos lidhur me këtë qështje me një vendim meritor, dhe nuk i kundërshtoj provat e administruara të cilat ekzistojnë në shkresat e lëndës, njëherit i kërkoj shpenzimet e procedurës sipas tarifës.

Me qëllim të vlerërimit sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruara si provë:Skica e identifikimit ,e datës 05.04.2017,e hartuar nga gjeodeti Faton Bislimi,si dhe dëgjimi i të njejtit ekspert në seancën e datës 19.05.2017,Certifikata

mbi të drejtata e pronës së paluejtshme nr [REDACTED] e datës 05.04.2017, janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve [REDACTED] [REDACTED] të dy nga [REDACTED] Komuna Ferizajit, si dhe është dëgjuar në cilësi të palës paditësi [REDACTED] [REDACTED]

Gjykata i ka vlerësuar provat sipas neni 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet Faton Bislimi të cilin ia ka prezantuar me shkrim Gykatës së bashku edhe me certifikatën nr [REDACTED] e datës 05.04.2017, si dhe dëgjimin e të njejtit ekspert në seancën gjyqësore të datës 19.05.2017, gjykata ka vërtetuar se paluajtshmëria kontestuese, konkretisht ngastrat kadastrale [REDACTED] Zona Kadastrale Kosinë në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Ferizaj, evidentohen në emër të paditurit [REDACTED] [REDACTED] dhe kan sipërfaqe prej 6449 m2, dhe se gjendja kadastrale përputhet me gjendjen faktike .

Nga deklaratat e dëshmitarëve [REDACTED] [REDACTED] si dhe paditësit [REDACTED] [REDACTED] në cilësi të palës gjykata ka vërtetuar se paditësi [REDACTED] nga Ferizaji, ngastrat kadastrale nr [REDACTED], Zona Kadastrale Kosinë, Komuna e Ferizajit i ka blerë në vitin 1984, nga i padituri [REDACTED] [REDACTED], nga [REDACTED], tani me adresë të panjohur të vendbanimit për qmimin e shitblerjes prej 200 milion dinarë, të cilën shumë paditësi i'a ka paguar në tërësi të paditurit [REDACTED] [REDACTED] ndërsa i padituri ngastrat kadastrale nr [REDACTED] i'a ka dorëzuar në posedim paditësit, kurse paditësi i ka në posedim ngastrat kadastrale nr [REDACTED] [REDACTED] që nga vitit 1984 e deri tani 2017 pa u penguar nga askush.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si në arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj .


Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :31.05.2017

Gjyqtari

Burim Emërllahu



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.